Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
01-04-2014
01-013/1441

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12.2 shkronja **d**) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr 28/2008, nenit 36.2 shkronja **d**) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013//491 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 31.03.2014 aprovon këtë:

# VENDIM
## PËR DHËNJEN E PËLQIMIT KOMPANISË PRIVATE EKO-ENERGJI PËR HULUMTIMIN NË FUSHËN E ENERGJISË

Neni 1.

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë JEP PËLQIM për hulumtim në fushën e hidroenergjisë në lumin Morava në fshatin Binçë, Kompanisë EKO-ENERGJI me pronar Islam Drogobuzhda

Neni 2.

Pronarit kompanisë i ipet pëlqimi për hulumtim në fushën e hidroenergjisë në lumin Morava mbi fshatin Binçë.

Dhënia e këtij pëlqimi nuk nënkupton të drejtën për ngritjen e kapaciteteve në prodhimin e hidroenergjisë.

Neni 3.

Pëlqimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës së Vitisë do ti shërbej Kompanisë Eko Energji për marrjen e lejes për hulumtim në fushën e hidroenergjisë në lumin Morava në fshatin Binçë pranë ministrive kompetente.

Komuna jep pëlqim që hulumtimi të bëhet brenda periudhës gjashtë mujore duke llogaritur nga data e marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim e Komunës së Vitisë.

Neni 5.

Ky vendim hynë në fuqi ditën nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT
Naim Pira